

Konferencë në Bruksel, lidhur me gjendjen e medimeve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë



04.11.2015 – Me moton “Speak up!”, sot në organizim të Komisionit Evropian, në Bruksel, po mbahet Konferenca e tretë për lirinë e të shprehurit dhe medimet në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Si përfaqësues të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, marrin pjesë drejtori i Agjencisë dr.Zoran Trajçevski dhe udhëheqësja e departamentit për bashkëpunim ndërkombëtar dr. Irena Bojaxhievska.

Dy konferencat e mëparshme të “Speak up!” që u organizuan nga Drejtoria e përgjithshme për zgjerim, siç u potencua edhe nga vet Komisioni Evropian, rezultuan me konkluzione të rëndësishme që u bënë pika të rëndësishme referuese për formulimin e politikave, qasjes për ndihmë si dhe gjatë ballafaqimit me çështjet e ndryshme të kësaj sfere.

Një numër i madh i personave nga shoqëria civile, gazetarë dhe përfaqësues të medimeve, mes të cilëve edhe Republika e Maqedonisë, së bashku me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, pritet që të diskutojnë dhe ti prezantojnë gjendjet e medimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Temat që janë në fokusin e konferencës i trajtojnë “medimet e reja” në kontekst të demokracisë dhe mendimit kritik, arsimimit mediatik, standardet profesionale dhe etike të gazetarisë si dhe kushtet për punë të gazetarëve.